

FJALA E DEPUTETIT ALBAN XHELILI

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

Të nderuar qytetarë,

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Kam dëgjuar diskutimet e sotme dhe një gjë më ka bërë për të qeshur, po jua them sinqerisht, se nuk e di ku e gjeni atë aftësi, unë të paktën nuk e gjej, që t'u jepni formula të gatshme qytetarëve shqiptarë, duke prezumuar sikur ata nuk janë të zotë të gjykojnë nëse ky buxhet është i mirë apo jo.

Dalim në këtë foltore e themi: "Ky buxhet nuk bën!". Ne duhet t'u japim qytetarëve shqiptarë të dhënat e këtij buxheti ose të këtij projektligji dhe më pas duhet të jenë ata që duhet ta vlerësojnë nëse bën apo jo. Ne duhet t'u themi qytetarëve shqiptarë që të ardhurat në këtë projektbuxhet janë 631,7 miliardë lekë ose 29,9% e produktit të brendshëm bruto, janë më të larta sesa viti 2022, pa i krahasuar me vitet e mëparshme, se nuk dua t'i kthehem vitit 2013 e më parë.

Shpenzimet buxhetore janë 687,2 miliardë lekë, 31,6% e PBB-së, që do të thotë se janë më të larta se një vit më parë, me prioritet arsimin, ku parashikohet një buxhet prej 3% të PBB-së; shëndetësia 3%; bujqësia do të përfitojë 14,2 miliardë lekë ose 120 milionë euro, ku do të përmendja mbështetjen për skemën kombëtare të fermerëve me 1,97 miliardë, mbështetjen nga IPARD III me 3,9 miliardë lekë dhe skemën e subvencioneve.

Lidhur me investimet publike dëgjova se vlera e investimeve publike në këtë projektbuxhet është 2%. Unë nuk e di, por të pjesëtosh 1,1 me 18,2 miliardë, që është buxheti, bëjnë 2, apo bëjnë 5,6%?!

Gjithashtu, ndryshe nga të gjitha situatat globale, le të themi, nuk kemi një recension, pra jemi gjithmonë me një rritje të parashikuar ekonomike, gjë të cilën e ka treguar edhe eksperiencia e vitit 2022.

Inflacioni parashikohet në nivelin 3,6%, me një rënie 6,3% gjatë periudhës janar-shtator 2022. Lidhur me inflacionin do të thosha se ky është një parashikim, pasi askush nga ne nuk mund të japë një përcaktim

ekzakt nëse do të ngelemi në këto nivele apo mund të jemi në nivele më të këqija apo më të mira inflacioni. Kjo do të varet e gjitha nga situata e luftës.

Siç flasim për pushtimin rus të Ukrainës dhe luftën fizike që bëhet atje, në terma ekonomikë do të thosha se jemi realisht në luftë në nivel global. Askush nuk mund të japë formula të sakta për momentin se si mund të dilet nga kjo situatë, pavarësisht se përpjekjet në nivel global janë të mëdha. Një nga përpjekjet më të mëdha është lufta kundër inflacionit. Këtu dëgjova se ka disa lloj inflacionesh. Unë di vetëm një formulë dhe një nivel inflacioni.

Lidhur me prioritetet, edhe mbrojtja zë një hapësirë, pavarësisht se gjithsecili nga ne do të donte nivele më të larta të përfshirjes në buxhet.

Unë do të prekja edhe ndryshimet që kanë ndodhur ose që janë pjesë e integruar e buxhetit, siç janë ligji “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” ose ndryshimet që kanë ndodhur në ligjin nr. 92/2014, ligji “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Po të shohim frymën e të gjitha ndryshimeve në këto tri ligje, e para është përkrahja që duhet t’u bëhet shtresave në nevojë; përbalimi i efekteve të krizës; përshtatja me direktivat e BE-së dhe njësimi me legjislacionin e atyre vendeve. Këtu flas për eliminimin e diferencimeve që janë përfshirë në ndryshimin e ligjit “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”.

Për sa i përket ndihmës, kemi bërë një ndryshim në ligjin nr. 92/2014, për përjashtimin e drurit dhe mbetjeve të tij, që përdoren për ngrohje, duke pasur parasysh edhe krizën aktuale energjetike.

Te procedura tatimore nuk është një ndryshim i ri ai që po ndodh, por është vijueshmëria e luftës kundër informalitetit dhe evazionit. Pra, gjobat nuk janë elemente që mund të përfshihen tek të ardhurat në buxhet dhe, po ta shikoni, aty nuk ka parashikime lidhur me të ardhurat nga gjobat, por janë thjesht elemente parandaluese për evazionin dhe për luftën ndaj evazionit.

Kemi dëgjuar që kjo shifër është e pamjaftueshme për këtë apo për atë, por kemi harruar të themi atë që ju thashë pak më parë, që ky buxhet është dyfishi i atij që ka qenë në një vit; është buxheti i qytetarëve, ku të ardhurat vijnë si rezultat i kontributit të çdo shqiptari dhe jo si rezultat i ndonjë financimi të huaj, siç edhe kemi dëgjuar shpesh kohët e fundit. Me lekët e qytetarëve nuk mund të bëjmë ç’të duam.

Pra, në këtë buxhet duhet të vlerësojmë raportin e performancës në mbledhjen e të ardhurave dhe eficiencën në përdorimit e tyre.

Ecuria në rritje e vjeljes së të ardhurave si rezultat i performancës, nga njëra anë, dhe ulja e borxhit dhe deficitit, në kahun tjetër, janë treguesit më të qartë të seriozitetit në hartimin e këtij projektligji dhe të përkujdesjes së qeverisë në mbështetje të shtresave në nevojë dhe ruajtjes së stabilitetit ekonomiko-financiar.

Nuk do të doja të zgjatesha, pavarësisht se kam shumë gjëra për të thënë (diskutimi për buxhetin është shumë i rëndësishëm dhe mua më dhemb, pasi edhe në profesion jam ekonomist), por dua të ndalem pak e të flas për qytetin tim.

Si deputet i qarkut të Durrësit dua të them edhe dy fjalë në lidhje me investimin strategjik, siç është porti turistik me vlerë 2 miliardë. Kur qytetarët durrsakë dëgjojnë ndonjë folës këtu që shprehet kundër këtij investimi shumë të rëndësishëm jo vetëm për qytetin tonë, por për mbarë Shqipërinë, instinktivisht shprehen kështu: “Ore, këta mirë që nuk bënë asgjë për Durrësin, por tani që dikush po mendon seriozisht për këtë qytet, përpiqen ta pengojnë!”, dhe thonë atë anekdotën: “Unë nuk dua asgjë, por as komshiut mos i jep asgjë!”. Pra, kur nuk bëtë asgjë të mirë për Durrësin, ju lutem, minimumi që mund të bëni është të rrini urtë dhe të mos i bëni keq!

Faleminderit!